



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Rruga "28 Nëntori", Shkodër (Shqipëri) Tel/Fax: 355 2224 2741,
www.qarkushkoder.org, E-mail: qarkushkoder@yahoo.com,

VENDIM

Nr. 1 . datë 26 / 03/ 2020

Mbi disa ndryshime në Rregulloren e Këshillit të Qarkut Shkodër *Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit të Qarkut Shkodër*

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen virtuale me datës 26/03/2020, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga Sekretari i Këshillit të Qarkut Shkodër "*Mbi disa ndryshime në Rregulloren e Këshillit të Qarkut Shkodër*", bazuar në: Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", përkatësisht në Nenin 77 germa a), pasi shqyrtoi materialin dhe kërkesën për miratimin e ndryshimeve të Rregullores "*Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit të Qarkut Shkodër*" pasi u diskutuan dhe u miratuan në mbledhjen e Kryesisë Këshillit të Qarkut Shkodër me dt.21/02/2020 u bë votim elektronik nga anëtarët e Këshillit të Qarkut Shkodër , miratohet me 17 vota pro, 1 votë kundra dhe 2 vota abstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren e Këshillit të Qarkut Shkodër "*Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit të Qarkut Shkodër*".
2. Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
5. Miratuar në datën 26/03/2020
6. Shpallur në datën 30/03/2020

K R Y E T A R I

Hilmi LAKTI



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË QARKUT
SHKODËR**

NENI 1

OBJEKTI I RREGULLORES

Kjo rregullore ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër në bazë të Kushtetutës, ligjeve, akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

NENI 2

STATUSI I KËSHILLIT

Këshilli Qarkut është person juridik, Ai është organ përfaqësues i qarkut dhe përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të Bashkive që bëjnë pjesë në Qark të cilët janë kurdoherë anëtarë të Këshillit të Qarkut së bashku me kryetarët e bashkive përkatëse.

Këshilli Qarkut vepron në bazë të parimit të autonomisë vendore.

NENI 3

ORGANIZIMI I KËSHILLIT

Numri i anëtarëve të Këshillit të Qarkut Shkodër është 21 veta. Ky numër përcaktohet sipas nenit 73 të ligjit nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Këshilli Qarkut Shkodër ka këtë strukturë organizative :

- Kryetari i Këshillit.
- Zëvendëskryetari i Këshillit.

- Sekretari i Këshillit.
- Kryesia e Këshillit të Qarkut. Shkodër.
- Komisionet e Këshillit.

Funksioni i anëtarit të Këshillit të Qarkut është i papajtueshëm me çdo funksion në administratën e këshillit të qarkut.

NENI 4

KONSTITUIMI I KËSHILLIT TË QARKUT

Mbledhja e parë e Këshillit të Qarkut thirret jo me vonë se 50 ditë nga Kryetari i Bashkisë, qendër Qarkut, ose 1/3 e anëtarëve të KQ, Ajo është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve të tjerë të tij. Mbledhja e parë e Këshillit deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Qarkut, drejtohet nga Kryetari i Bashkisë qendër Qarku.

Në mbledhjen e tij të parë Këshilli Qarkut:

- Zgjedh komisionin e mandateve i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit.
- Vërteton mandatet e anëtarëve të Këshillit.
- Zgjedh kryetarin, zëvendës kryetarin dhe kryesinë e Këshillit të Qarkut. Mandatin e Anëtarit të Këshillit të Qarkut e fitojnë të gjithë kryetarët e bashkive përbërëse të tij në përputhje me nenin 74 dhe 75 të ligjit nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Anëtarit të Këshillit të Qarkut i mbaron mandati kur:

- Humbet mandatin si kryetar i Bashkisë.
- Mandati i anëtarit hiqet nga këshilli bashkiak dhe zëvendësohet po nga i njëjti këshill.
- vërtetohet se mandati është fituar në mënyre të paligjshme.

NENI 5

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË QARKUT

Këshilli i Qarkut ushtron kompetencat e tij nga çasti i konstituimit deri në konstituimin e këshillit pasardhës.

Mbledhja e Këshillit të Qarkut quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të tij dhe zhvillohet sipas nenit 76, 77 dhe 78 të Ligjit 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Mbledhja e radhës e Këshillit të Qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sipas një programi të miratuar, thirrja bëhet nga kryetari.

Këshilli i Qarkut mblidhet jashtë radhe me kërkesë të:

- a) Kryetarit të tij.
- b) Kryesisë së Këshillit.
- c) Një të tretës së anëtarëve të Këshillit.
- d) Të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Njoftimi për mbledhjen përmban datën e mbledhjes, orën, vendin, rendin e ditës dhe bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes.

Kryesia e Këshillit të Qarkut thirret në mbledhje nga Kryetari jo më pak se një herë në muaj.

NENI 6

KOPETENCAT E KËSHILLIT TË QARKUT

Këshilli i Qarkut miraton statusin dhe rregulloren e tij të brendshme të funksionimit.

Vendos për nivelin e ndihmesave financiare të detyrueshme të çdo Bashkie përbërëse në buxhetin e qarkut.

Zgjedh dhe shkarkon nga anëtarët e Këshillit të Qarkut kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe anëtarët e kryesisë.

Emëron dhe shkarkon sekretarin e Këshillit të Qarkut. Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, numrin e personelit, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, personave të tjerë juridik që krijojnë vetë ose është bashkëthemelues.

Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.

Miraton tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm.

Vendos për taksat dhe tarifatat në kompetencë të qarkut si dhe për nivelin e tyre.

Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.

Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta. Me njësi të tjera të qeverisjes vendore dhe personave të trete.

Emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë së tij.

Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.

Vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut.

Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve të deleguara në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark.

Vendos për simbolet e qarkut.

Jep tituj nderi e stimuj.

Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark.

Miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së qarkut.

NENI 7

KRYESIA E KËSHILLIT TË QARKUT

Kryesia përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë të tjerë.

Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

Miraton projekt-aktet dhe materialet e tjera që kërkon ajo vetë apo këshilli në përputhje me rendin e ditës e tematikën e mbledhjeve të këshillit.

Raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare çdo 6 muaj ose me shpesh.

Raporton në këshill për probleme që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut dhe ushtron të drejtat që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.

Nxjerr vendime që marrin fuqi detyruese për tu zbatuar nga organet, personat dhe subjektet e interesuara.

Vendimet e kryesisë duhet të raportohen e të miratohen në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Qarkut në rast të kundërt e humbasin fuqinë e tyre.

NENI 8

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Kryetari i Këshillit përfaqëson Këshilli e Qarkut në marrëdhënie me organet shtetërore, me organet e njësisive të qeverisjes vendore, me persona juridik ose fizik vendas ose të huaj.

Kryeson mbledhjet e Këshillit të Qarkut dhe ato të kryesisë së tij.

Nënshkruan të gjitha aktet e këshillit, kryesisë së këshillit dhe proces-verbalet e këtyre mbledhjeve.

Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Qarkut dhe të kryesisë së tij.

Në përputhje me tematikën e mbledhjeve të kryesisë e të këshillit, miraton raportet, projekt-vendimet e materialet e tjera të nevojshme të ardhura nga departamentet e këshillit dhe institucionet përkatëse.

Drejton administratën e Këshillit të Qarkut dhe përgjigjet për funksionimin e saj.

Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së Këshillit të Qarkut përveç rasteve të parashikuara ndryshe nga ligji nr. 152/2013 (Për Nëpunësin Civil).

Garanton kryerjen e funksioneve të Këshillit të Qarkut, funksionimin normal të strukturave të tij.

Ushtron kompetenca të tjera që i ngarkohen me ligj.

Në mungesë të kryetarit funksionet e tij kryhen nga zëvendës-kryetari.

NENI 9

SEKRETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Sekretari i Këshillit të Qarkut emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Qarkut. Mbështetur në nenin 57 dhe 84 të ligjit nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE” Ai është përgjegjës për :

- Mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit.
- Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës.
- Njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit.
- Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga Këshilli i Qarkut.
- Mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
- Përgatitjen e mbledhjeve të komisioneve të Këshillit
- Sekretari i Këshillit të Qarkut kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga këshilli.

NENI 10

GRUPET E KËSHILLTARËVE

1. Këshilltarët formojnë grupe sipas përkatësisë së tyre politike.

Çdo grup ka jo më pak se tre anëtarë.

Formimi i grupit deklarohet në Këshill dhe një kopje e shkresës së deklaratës dorëzohet dhe shënohet në protokoll e plotësuar me emrin e grupit.

me listën e grupit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe kryetari i grupit

Grupi cakton anëtarin që flet në emër të tij për një problem të caktuar dhe mund të shprehë mendimin unik të gjithë anëtarëve të grupit ose radhën e diskutimeve të anëtarëve të grupit.

NENI 11

KOMISIONET E KËSHILLTARËVE

Komisionet e Këshillit janë organe të Këshillit që kryejnë funksione për njohjen dhe realizimin e iniciativës dhe të kontrollit në kuadrin e detyrave dhe kompetencave ligjore të Këshillit.

Këshilltarët kanë të drejtë të formojnë komisione.

Komisionet e këshilltarëve dhe ndryshimet në përbërjen e tyre shkruhen në regjistër të veçantë. Çdo komision i formuar sipas përkatësisë partiake apo orientimit politik, përcakton këshilltarë që do të diskutojnë në emër të tyre.

Listat e grupeve dhe drejtuesve të tyre paraqiten tek kryetari.

Komisionet e këshillit janë të përhershëm e të përkohshëm.

1. Komisioni i Mandateve
2. Komisioni i Buxhetit e Financave
3. Komisioni i Shërbimeve dhe Emergjencave civile
4. Komisioni Politikave të zhvillimit rajonal i Planifikimit Urban
5. Komisioni i për Administrimin dhe Mbrojtjen Tokave Bujqësore
6. Komisioni i Bashkëpunimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
7. Komisioni Juridik, i Vlerësimit të Figurave dhe i shqyrtimit të kërkesave për Pensione të Posaçme Shtetërore.

Numri dhe anëtarët e komisioneve zgjidhen me votim të hapur me propozim të Kryetarit të Këshillit pas konsultimit me kryetarët e grupeve.

Kryetarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e tyre.

Komisionet diskutojnë projektet e përgatitura nga Kryetari dhe administrata e tij dhe i propozojnë Këshillit pranimin ose jo të tyre, ndryshimin dhe plotësimin e tyre.

Këshilli mund të bëjë ndryshime në llojin, numrin dhe përbërjen e komisioneve të këshillit. Në komisione mund të ftohen për konsultime, pa të drejtë vote, edhe persona të jashtëm apo ekspertë për çështje të ndryshme.

Komisioni i ligjeve shqyrton projekt-vendimet apo projekt-aktet e tjera që do t'i paraqiten mbledhjes së këshillit dhe jep relacion me shkrim për pajtueshmërinë e tyre me dispozitat ligjore në fuqi.

Mbledhjet e komisionit janë gjithmonë të hapura, përveç rasteve që parashikon ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Nëpunësit e administratës së këshillit, ndërmarrjeve të varësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore janë të detyruar t'u japin të dhënat që kërkohen nga komisionet e Këshillit.

Komisioni mblidhet me thirrjen e Kryetarit, të zëvendëskryetarit, apo 1/3 e anëtarëve.

Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë më tepër se gjysma e këshilltarëve.

NENI 12

MBLEDHJET E KËSHILLIT

Mbledhjet e Këshillit të Qarkut janë të hapura për publikun dhe mediet.

Këshilli mund të vendosë me shumicë votash të numrit të anëtarëve që mbledhje të veçanta të tij të bëjë të mbyllura.

Kryetari i Këshillit hap mbledhjen kur verifikohet pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së këshilltarëve.

Mbledhja fillon me miratimin e rendit të ditës të paracaktuar në njoftimin e mbledhjes.

Mbas miratimit të rendit të ditës, fillon shqyrtimi i çështjeve sipas radhës.

Propozimi për ndryshimin e radhës bëhet me miratimin e shumicës së këshilltarëve të pranishëm.

Çdo këshilltar që diskuton ka të drejtë të flasë për një kohë jo më tepër se 5 (pesë) minuta me përjashtim të rasteve të veçanta kur Këshilli vendos ndryshe. Këshilltari nuk mund të diskutojë më shumë se njëherë për një problem që është në diskutim.

Fjala në mbledhje kërkohet me ngritjen e dorës. Këshilltarët kanë të drejtë të drejtojnë personave përgjegjës pyetje për problematikat që shqyrtohen në këshill. Të drejtën e fjalës e jep Kryetari i këshillit. Koha e fjalës është e barabartë për të gjithë folësit. Nëse këshilltari del nga tema, Kryetari i Këshillit i tërheq vëmendjen, nëse edhe pas kësaj këshilltari vazhdon të dalë nga tema atëherë atij i ndërpritet fjala. Fjala ndërpritet edhe kur diskutanti kalon kohën. Këshilltarët kanë të drejtë të diskutojnë vetëm një herë për një problem të caktuar. Në rastet kur diskutohet për probleme individuale ose të adresuara drejt një grupi të caktuar, kanë të drejtë replike të shkurtër individët ose grupet.

Këshilltarët nuk lejohet të përdorin fjalë ofenduese dhe fyese në adresë të kolegëve e qytetarëve për asnjë lloj arsyeje. Në rast të kundërt Kryetari i propozon këshilltarëve largimin nga mbledhja të këshilltarit. Lejohet mbajtja e celulareve në nivelin e ziles pa tinguj, gjendje të heshtur apo silencioze.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit mund të marrin fjalën për diskutim sa herë që e kërkojnë. Të drejtën për të dhënë sqarime kur u kërkohet nga këshilltarët për materialet e

paraqitura e kanë Kryetarët e komisioneve të Këshillit dhe Drejtuesit e strukturave të administratës së K.Q. Shkodër.

Me mbylljen e diskutimeve rreth pikave të rendit të ditës kryetari shpall mbylljen e debatit. Me mbylljen e debatit kryesuesi deklaron fillimin e votimit. Asnjë këshilltari nuk i jepet e drejta e fjalës mbas fillimit të votimit.

Votimi bëhet sipas radhës me “pro”, “kundër” dhe “abstenim”

Votimi bëhet i fshehtë në rastet me karakter individual. Vendimet merren me numrin e nevojshëm të votave të përcaktuar me ligj.

Kryetari pezullon mbledhjen në rast se në procesin e votimit rezulton se nuk sigurohet shumica e mjaftueshme e këshilltarëve që kërkohet për votim.

Kryetari vendos rregull dhe qetësi dhe në rastet kur shkelen rregullat e mbledhjes Kryetari mund të urdhërojë që persona të veçante që pengojnë zhvillimin e mbledhjes të dalin jashtë.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes së këshillit nuk lejohet të pihet duhan.

Në rastet kur në sallë bëhet rrëmuje dhe nuk merren parasysht kërkesat e drejtuesit të mbledhjes për mbajtjen e rregullit, Kryetari e lë vendin e tij dhe çdo diskutim quhet i mbyllur.

NENI 13

PARAQITJA E PROJEKT-VENDIMEVE NË KËSHILL

Kryetari, Kryesia e Këshillit të Qarkut, komisionet e përhershme, këshilltarë të veçantë, paraqesin në këshill projekt-vendimet dhe projekt-urdhëresat së bashku me relacionet përkatëse.

Përpara se të kalohen për miratim në këshill, diskutohen në komisione, firmosen nga drejtoritë, sektori apo specialistët, sekretari i Këshillit të Qarkut, i drejtohen Kryetarit të Këshillit dhe regjistrohen në librin e akteve të këshillit.

Kryetari përmes sekretarit të këshillit, bën shpërndarjen sipas akteve ligjore subjekteve të interesuara.

Pas diskutimeve dhe shqyrtimeve të projekteve në këshill kalohet në vendim.

Një kopje e vendimit ruhet në arshivën e institucionit të Qarkut në bazë të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 «Për arkivat».

NENI 14

PROCES - VERBALI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT.

Proces- verbali do të mbahet në një libër të veçantë në të cilin është shkruar Libri i proces-verbaleve të mbledhjeve të K. Q. Shkodër, dhe do të mbahet nga një person i caktuar nga Kryetari si dhe do mirëmbahen e ruhen nga Sekretari i K. Q. Shkodër.

Në proces-verbalin e mbledhjes do të jenë shprehur qartë:

- Data, Ora dhe Vendi i mbajtjes së mbledhjes.
- Numri i Këshilltarëve të pranishëm.
- Rendi i ditës.
- Projekt-vendimet që do të diskutohen të ndjekura me 5 vija apo radhë bosh për të shkruar diskutimet, ndryshimet apo propozimet që dalin nga këshilltarët.
- Votat: “Pro”, “Kundër”, “Abstenim” për çdo çështje për të cilën është marrë një vendim.
- Firmat e Kryetarit, Zëvendëskryetarit, Sekretarit dhe jo më pak se 5 Këshilltarëve.
- Sekretari i K. Q. Shkodër është përgjegjës për mbajtjen me përpikëri të proces-verbaleve të mbledhjeve të K. Q. Shkodër.
- Në mbledhjen e radhës të K. Q. Shkodër, në pikën e parë të rendit të ditës të miratohet proces-verbali i mbledhjes së kaluar i shpërndarë i printuar për secilin anëtar të Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Ne proces- verbal pasqyrohen dhe qëndrimet kundër.

Sekretari i Këshillit ndjek shprehjen e ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Qarkut nga institucioni i Prefektit sipas ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”.

NENI 15

VOTIMI

Votimi në këshill është individual. E drejta e votës nuk mund të delegohet. Votimi mund të kryhet i hapur ose i fshehtë. Votimi i hapur kryhet me ngritjen e dorës me votim të përgjithshëm.

Votimi i fshehtë kryhet me fletë-votimi. Për organizimin e votimit ngarkohen sekretaria e zgjedhur për numërimin e votave ose krijohet një komision i veçantë i përbërë nga grupe të ndryshme këshilltarësh.

Aktet me karakter nominal votohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Votimi i fshehtë nuk bëhet për vendime financiare që lidhen me buxhetin.

Kur votimi behet i fshehtë sekretari i këshillit bën administrimin e votimit dhe shpall rezultatin e tij. Rezultatet e votimit regjistrohen në proces-verbalin e mbledhjes.

Këshilltari i Qarkut nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur ai vetë, bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehri, vjehrra, dhëndri e nusja e tij kanë interes pasuror ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill.

NENI 16

VLEFSHMËRIA E AKTEVE DHE SHPALLJA E TYRE

Një akt i Këshillit të Qarkut bëhet i ligjshëm kur ai është hartuar sipas ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Qarkut, është shqyrtuar duke u miratuar dhe votuar sipas procedurave të kësaj rregulloreje dhe është i regjistruar në proces-verbalin e mbledhjes, por dhe ky i fundit i firmosur sipas kësaj rregulloreje.

- Vendimet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

NENI 17

Kjo projekt-rregullore është përditësim i rregullores së mëparshme.

Çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë projekt-rregullore rregullohet me ligj.

NENI 18

SHFUQIZIMI

Rregullorja e mëparshme me vendim Nr. 13 datë 02/11/2016 e Këshillit të Qarkut Shkodër shfuqizohet.

KRYETAR

Hilmi Lakti